



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË



NOTER JULIAN ZHELEGU  
ADRESA Njesia Bashkiake nr. 5, Rr.  
Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr.  
2  
TEL: 042255528

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 3383

Nr. koleksioni: 1065

Tirane më 12/04/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë"



A2022053950103037028



A2022053950103037028

Taksa e P  
u Likujd



## KONTRATE SHITJE KUOTE

Sot, ne Tirane, me 12 / 04 / 2022, përpara meje Julian Zhelegu, Noter pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, lidhet kjo Kontrate Shitje Kuote nga dhe ndërmjet:

### SHITESIT:

**Alfred Sadikaj**, atësia Petref, amësia Qerime, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në Tiranë, me adresë B.Curri; Nd. 1845; Ap. 076; Njësia Administrative Nr. 5; Njesia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 13/07/1968, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033951650 dhe nr. personal G80713161W,

### SHITES:

**Entela Haxhialiu**, atësia Irfan, amësia Fitnet, shtetase Shqiptare, lindur në Berat dhe banuese në Tiranë, me adresë B.Curri; Nd. 1845; Ap. 076; Njësia Administrative Nr. 5; Njesia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 16/03/1973, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033955749 dhe nr. personal H35316047J,

dhe

### BLERESI:

**Klodian Melëngu**, atësia Miltjadh, amësia Dashmira, shtetas Shqiptar, lindur në Berat dhe banues në KUÇOVË, me adresë Kristaq Lacka 00170068; Nd. 17; H. 1; Ap. 10; Kuçovë; Kuçovë; 5301; Kuçovë, lindur më 05/08/1983, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034220785 dhe nr. personal I30805057N,

Palët e mësipërme ne vijim dhe për efekt të kësaj Kontrate, do të referohen individualisht si "Pale/a" dhe së bashku si "Pale/et".

### MEQENESE:

- A. Shitësi janë ortakë, zotërues të dy së bashku të 100% (njëqind përqind) të kuotave të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "AlbEsp Trading & Consulting" shpk. (ne vijim "**Shoqëria**"), shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar e që funksionon në përputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me Numër Unik Identifikimi NUIS M12221008I DHE me seli në TIRANË Njesia bashkiake nr. 5, Rruga Vaso Pasha, Hyrja 1, Ap. 10, zona kadastrale 8270, pasuria nr. 5/325+1-10, kapitali themeltar i regjistruar i të cilës është në shumën ALL 100.000 (njëqind mijë Lekë), sikurse rezultojnë nga Ekstrakti i Regjistrimit Tregtar lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
- B. Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësit gjithsej 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit të Shoqërisë (ne vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "**Kuota**"), konkretisht 25 % të kuotave do të shiten nga Alfred Sadikaj dhe 26 % e kuotave do të shiten nga Entela Haxhialiu, dhe Blerësi dëshiron të blejë 51 % të kapitalit gjithsej, duke mbajtur parasysh se Blerësi është angazhuar të shlyejë të gjitha huatë që ortakët i kanë dhënë shoqërisë "AlbEsp Trading & Consulting" shpk.
- C. Shitësi angazhohet dhe garanton blerësit që brenda dhe jo më vonë se data 31.0.2022 do të marrë dhe do të vendosë në dispozicion të blerësit, Miratimin përkatës të bordit të ERE, për transferimin e kuotave sipas kësaj kontrate, në bazë të pikës 5.2 të kushteve të license për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike me nr. Serie T21 dhe nr. License 493 lëshuar nga Enti Rregullator i Energjisë në favor të shoqërisë "AlbEsp Trading & Consulting" shpk. Autorizimi do të jetë pjesë



A2022053950103037028

integrale e kesaj kontrate dhe kjo kontrate nuk do te prodhoje efekte ligjore pa miratimin e bordit te ERE por palet bien dakort qe nje kopje ta depozitojne ne QKB, menjehere me nenshkrimin e kontrates, por me kushtin qe regjistrimi i kuotave ne favor te bleresit te realizohet vetem pas depozitimit ne QKB te vendimit te miratimit te transferimit te kuotave nga Bordi i ERE.

- D. Kalimi i Kuotës sipas kësaj Kontrate është miratuar me vendimin bashkëlidhur të Asamblese së Ortakeve të Shoqërisë.
- E. Nga verifikimi i Regjistrimit të Barreve Siguresë, Kuota rezulton të jete e lire dhe e pa barrësuar.

**PER SA ME SIPER,** Palët ranë dakord për të lidhur këtë Kontrate Shitje Kuote.

## NENI 1 OBJEKTI

- 1.1. Objekt i kësaj kontrate është kalimi i pronësisë së Kuotës nga Shitësi të Blerësi dhe fitimi i pronësisë mbi Kuotën që përfaqëson 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë nga Blerësi, konkretisht 25 % të kuotave do të shiten nga Alfred Sadikaj dhe 26 % e kuotave do të shiten nga Entela Haxhialiu, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Kontrate.
- 1.2. Me lidhjen e kësaj Kontrate pronësia mbi Kuotën kalon nga Shitësi të Blerësi ku Blerësi fiton pronësinë e 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit të Shoqërisë.

## NENI 2 ÇMIMI DHE MENYRA E PAGESES

- 2.1. Çmimi i shitjes së Kuotës që përfaqëson 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit të Shoqërisë është LEK 51.000 (pesëdhjetë e një mijë lekë) dhe palet konfirmojnë se është paguar mes tyre me para në dore, përpara lidhjes së kontratës dhe jashtë zyrës së noterisë dhe nuk kanë pretendime në lidhje me pagesën e kryer.
- 2.2. Çmimi i shitjes gjendet i drejtë dhe i arsyeshëm, duke mbajtur parasysh parakushtin e pikës B të parashtrësive hyrëse, dhe Palët garantojnë se me nënshkrimin e kësaj Kontrate nuk do të kenë asnjë pretendim të çfarëdolloji në lidhje me çmimin e shitjes.

## NENI 3 KALIMI I PRONËSISË MBI KUOTEN

- 3.1. Pronësia mbi Kuotën që përfaqëson 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë do të kalojë nga Shitësi të Blerësi menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate, e cila do të regjistrohet menjëherë në librat e Shoqërisë si dhe në Regjistrin Tregtar sipas ligjit.
- 3.2. Palët konfirmojnë se struktura e zotërimit të kapitalit të Shoqërisë, me lidhjen e kësaj Kontrate, do të jete si vijon:
- z. *Alfred Sadikaj* zoterues i 1 kuote që përfaqëson 25 % të kapitalit;
  - znj. *Entela Haxhialiu* zoterues i 1 kuote që përfaqëson 24 % të kapitalit;
  - z. *Klodian Melëngu* zoterues i 1 kuote që përfaqëson 51 % të kapitalit.

## NENI 4 DEKLARATA DHE GARANCI

- 4.1. Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se:
- a. Shoqëria ekziston në mënyrë të ligjshme dhe kryen veprimtarinë tregtare sipas objektivit të saj të deklaruar.



A2022053950103037028

- b. Shitësi është zotëruesi i vetëm i Kuotës se Shoqërisë dhe ai gëzon gjithë të drejtat e votës dhe çdo të drejtë tjetër që rrjedh nga Kuota dhe ka tagra te plota për të shitur Kuotën e zotëruar prej tij. Kuota është nënshkruar dhe paguar plotësisht.
  - c. Kuota e zotëruar nga Shitësi është lirishit e transferueshme dhe asnjë miratim tjetër nuk nevojitet për realizimin e kalimit të pronësisë mbi Kuotën sipas kësaj Kontrate. Shitësi i jep Blerësit garancitë më të plota të eviksionit dhe garanton se në rast se ndonjë palë e tretë do të ngrejë pretendime në lidhje me të drejta mbi Kuotën, Shitësi do të garantojë që pronësia e Blerësit mbi Kuotën të mos cenohet në asnjë mënyrë a masë.
  - d. Kuota është e lirë nga çdo lloj pengu, detyrimi, takse, pretendimi, të drejta parablerjeje, apo barre tjetër dhe asnjë person i tretë nuk ka asnjë të drejtë reale apo garancie mbi Kuotën. Shitësi ka të drejtë të shesë dhe t'ia transferojë Kuotën Blerësit sipas kësaj Kontrate. Blerësi fiton të drejtat e plota e të pakufizuara të pronësisë mbi Kuotën sipas kësaj Kontrate.
  - e. Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Shitësi, nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumentet e tjera ligjore në të cilat Shitësi është palë.
  - f. Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se deklaratimet dhe garancitë e dhëna sipas kësaj Kontrate janë të vërteta, të sakta dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit.
- 4.2. Blerësi deklaron dhe garanton Shitësin se:
- a. Blerësi ka tagra te plota për të blerë Kuotën sipas kushteve dhe afateve të kësaj Kontrate.
  - b. Blerësi deklaron e garanton se e njëj gjendjen financiare dhe kontabile të Shoqërisë dhe se dëshiron të fitojë pronësinë mbi Kuotën pa rezerva të asnjë lloji si dhe pranon kushtin e financimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë sipas marrëveshjes së njëkohshme që do të lidhet me Shoqërinë. Blerësi njëj dhe pranon tërësisht dhe pa rezerva Statutin e shoqërisë dhe aktet e tjera rregulluese të veprimtarisë së saj.
  - c. Blerësi ka paguar çmimin e shitjes sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate.
  - d. Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Blerësi, nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumentet e tjera ligjore në të cilat Blerësi është palë.
  - e. Blerësi deklaron dhe garanton Shitësit se deklaratimet dhe garancitë e dhëna sipas kësaj Kontrate janë të vërteta, të sakta dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit.

## Neni 5 DISPOZITA TE FUNDIT

- 5.1. Kjo Kontrate hyn në fuqi me nënshkrimin e saj.
- 5.2. Çdo kusht, klauzolë apo parashikim i kësaj Kontrate do të jetë i vlefshëm pavarësisht kushteve, klauzoleve apo parashikimeve të tjera dhe vlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi nuk do të cenohet nga pavlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi tjetër.
- 5.3. Kjo Kontrate përmban marrëveshjen e plote ndërmjet palëve në lidhje me objektin e përcaktuar këtu dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme, me gojë apo me shkrim, ndërmjet Palëve, në lidhje me objektin e kësaj Kontrate.
- 5.4. Kjo Kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, dhe nenet 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
- 5.5. Çdo konflikt apo mosmarrëveshje që lidhet me hartimin, interpretimin apo zbatimin e kësaj Kontrate, që nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet Palëve, do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

*Kontratës i bashkëlidhen kopje të dokumenteve të identifikimit të Palëve dhe Aneksi A (Ekstrakt nga Regjistri Tregtar i Shoqërisë) dhe Aneksi B ((Vendimi i Ortakeve të Shoqërisë për miratimin e transferimit të Kuotës).*



A2022053950103037028

Unë Noteri e hartova këtë Kontratë sipas kërkesës së Palëve në gjuhën Shqipe dhe në katër originalë e pasi ua lexova me zë të lartë e të qartë, u gjet në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, të shprehur përpara meje, nënshkruhet prej tyre rregullisht në praninë time dhe unë e vërtetoj sipas ligjit dhe për të gjithë pasojat e tij.

**SHITËSIT**

*Alfred Sadikaj*

*Entela Haxhiali*

**BLERËSI**

*Klodian Melëngu*

**NOTERI**  
**Julian Zhelegu**

Prot. No. 32

Tiranë, 11.04.2022

**VENDIM**  
**I ORTAKEVE TE ASAMBLESE SE SHOQERISE**  
**"AlbEsp Trading & Consulting" SH.P.K.**

Sot, me date 11.04.2022, ortakët e shoqërisë "AlbEsp Trading & Consulting" Sh.P.K. (në vijim "Shoqëria"), shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar e që funksionon në përputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me Numer Unik Identifikimi NUIS M122210081, me seli në Tiranë, Njesia bashkiake nr. 5, Rruga "Vaso Pasha", Hyrja 1, Ap. 10, zona kadastrale 8270, pasuria nr. 5/325+1-10, me miratimin dhe pjesëmarrjen e ortakëve të shoqërisë që përfaqësojnë 100% të kuotave të kapitalit, pasi shqyrtuan pikat e mëposhtme të rendit të ditës:

1. Dhenia e miratimit përkatës për transferimin e 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit të shoqërisë në favor të blerësit Klodian Melëngu;
2. Te tjera eventuale;


Ne përputhje me Statutin dhe Ligjin 9901/2008, të ndryshuar, ortakët e shoqërisë

**VENDOSEN:**

1. Të miratojnë transferimin e 51% të kapitalit të shoqërisë (konkretisht 26% do të transferohet nga kapitali i Entela Haxhialiu dhe 25% nga kapitali i Alfred Sadikaj) në favor të Z. Klodian Melëngu. Marreveshja për transferimin e kuotes sipas këtij vendimi mund të konkludohet pa asnjë kufizim kohor pas miratimit të këtij vendimi. Kushtet e transferimit përcaktohen lirisht nga palet kontraktore pa kufizim.
2. Ky Vendim depozitohet për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me kërkesat e Ligjit "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjit "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" së bashku me marreveshjen përkatëse të transferimit të kuotave me qëllim pasqyrimin e ndryshimeve në të dhenat e regjistruara të Shoqërisë.

**ORTAKET E SHOQERISE**  
**"AlbEsp Trading & Consulting" SH.P.K.**

Alfred Sadikaj



"AlbEsp Trading & Consulting"  
Sh.p.k.  
NUIS : M122210081  
TIRANE - ALBANIA

Entela Haxhialiu

